

KERKESE-PADI

Drejtuar: Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm _____

PADITES :

Emri. _____ 2. Mbiemri _____ 3. Atësia _____ 4. Adresa e banimit të përhershëm ose te përkohshëm _____ 5. Nr. i telefonit _____ .E-mail _____

Kërkesa për nr. e tel dhe adresën e emailit nuk janë te detyrueshme por ndihmojnë ne shpejtimin e procesit nëpërmjet njoftimeve te shpejta)

I PADITUR :

Emri. _____ 2. Mbiemri _____ 3. Atësia _____ 4. Adresa e banimit të përhershëm ose te përkohshëm _____

OBJEKTI I PADISE :

Zgjidhjen e martesës, lënien e fëmijëve _____ dhe _____, përkatësisht të datëlindjeve _____ dhe _____, për rritje dhe edukim paditëses _____; caktimin e detyrimit ushqimor të të paditurit në masën që duket e arsyeshme të kërkohet.

BAZA LIGJORE E PADISE :

Nenet 132 , 138, 153, 154 e vijues të kodit të familjes, nenet 153, 154, të Kodit të Procedurës Civile;

PARAQITJA E FAKTEVE;

Ne këtë rubrike duhen sqaruar faktet mbi te cilat bazohet padia.

Faktet qe duhet te sqarohen lidhen me rrethanat për te cilat kërkohet zgjidhja e martesës; faktet përse kërkohet që fëmijët t'i lihen për rritje dhe edukim palës paditëse si dhe faktet dhe masa në çfarë shumë kërkohet detyrimi ushqimor (përafërsisht)

ARGUMENTAT LIDHUR ME KUSHTET LIGJORE

Ne këtë rubrike duhet te sqarohet lidhja e fakteve te pasqyruara ne rubrikën e mësipërme, rritjen e nevojës se fëmijëve për kontribut financiar; të ardhurat përkatëse të prindërve, etj.

AKTI I EKSPERTIMIT

Sipas ndryshimeve te Kodit te Procedures Civile, kjo rubrikë duhet të përmbajë ne menyre te detajuar llojin e aktit te ekspertimit qe kerkohet te kryhet gjate gjykimit ne funksion te orientimit te gjykates ne dhenien e nje vendimi sa me te drejte, ne interesin me te larte te te miturit;

LISTA E PROVAVE QE I BASHKALIDHEN PADISE;

Kjo rubrike duhet te përmbaje dokumentet qe duhet te paraqiten ne gjykate, te tilla si;

- certifikatat përkatëse të gjendjes civile (certifikatë personale e secilit bashkeshort, certifikatë personale e secilit fëmijë, certifikatë e trungut familjar, certifikatë martesë
- dokumente qe tregojnë te ardhurat dhe gjendjen ekonomike te te dy prindërve, te tilla si, dokumente pronësie te pasurive te ndryshme te regjistruara te luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe vertetim punesimi nese jane te punesuar;

PADITES

Nënshkrimi i personit qe paraqet padinë

Shënim:

Ky model kërkesë padie plotësohet në rast se jemi përpara kushteve të parashikuara në nenin 132 të Kodit të Familjes, pra, nëse mes bashkëshortëve ka grindje, fyerje e keqtrajtime te vazhdueshme, për shkak të shkeljes së besnikërisë bashkëshortore etj.

